



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH NË PRITJEN ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

12 dhjetor 2011

Zonja Kryetare e Kuvendit Jozefina Topalli,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme Edmond Haxhinasto,
Të dashur miq të të Drejtave të Njeriut dhe OSBE-së,

Sot, ne shënojmë Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Është bërë traditë në Tiranë që këtë ta bëjë Prezenca e OSBE-së në këtë format solemn.

Sot, teksa jetojmë në Evropë, përmendja e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut është bërë shumë e zakonshme. Të gjithë duket sikur bien dakord kur bie fjala tek të drejtat e njeriut. A nuk jemi ne të gjithë të angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut? Po, sigurisht, por a mjafton që të biem dakord: mbrojtja e vërtetë e të drejtave të njeriut kërkon më shumë vullnet të mirë, më shumë sesa një kuadër ligjor të detajuar. Të drejtat e njeriut duhet të jenë të drejta të jetës sonë individuale, duke filluar nga vetë familjet tona.

Sot, kur flasim për të Drejtat e Njeriut, ne flasim para së gjithash për dinjitetin njerëzor dhe për respektimin e jetës njerëzore. Ky respekt fillon në shtëpitë tona, në mënyrën se si trajtojmë fëmijët tanë dhe anëtarët e tjerë të familjes rreth nesh. Fëmijët dhe, në veçanti jetimët, përbëjnë grupin më të dobët në shoqërinë tonë. Nëse dështon individi, nëse dështojnë prindërit, nëse dështon familja, është Shteti ai që duhet të ndërhyjë. Nëse Shteti dështon në mënyrë të përsëritur, sidomos në një shkallë të madhe, apo nëse Shteti nuk është në gjendje t'i mbrojë ato, hyn në lojë Komuniteti Ndërkombëtar.

Sot, kjo gjë vlen në më shumë fusha ku të drejtat individuale meritojnë mbrojtje. Në bazë të të gjitha veprimeve tona duhet të qëndrojmë një parim – parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit: barazi e plotë para ligjit në të gjitha fushat aq të larmishme sa aksesit në drejtësi apo aksesit në kujdesin shëndetësor. Mbrojtja ligjore mund të kërkojë kundër të gjitha llojeve të diskriminimit, qoftë diskriminimit në bazë të racës, moshës, gjinisë, apo aftësisë së kufizuar, dhe këto janë vetëm disa prej tyre. Gjithashtu, le të mos harrojmë në këto raste se parimi i barazisë duhet të respektohet nga ne, si persona, si qytetarë, në çdo kohë, kur ndërveprojmë me njëri-tjetrin.

Edukimi për të drejtat e njeriut është një detyrë fisnike dhe shumë e nevojshme, e cila është jetësore për ndërtimin dhe stabilizimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse nga ana sociale.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri përpiqet mes punës së saj të besueshme bashkë me qeverinë shqiptare që mbrojtja e të drejtave të njeriut të jetë në krye të përpjekjeve shqiptare dhe që Shqipëria të jetë plotësisht e angazhuar për të garantuar që parimet e të drejtave të njeriut të jenë pjesë e pandashme e politikave të saj në zbatimin e kuadrit të saj ligjor modern dhe shumë të lavdërueshëm.

Më lejoni edhe një herë t'ju ftoj të gjithëve që, secili në mënyrë shumë individuale, të fiksojë në mendje dhe në zemër, se ndërkohë që nga njëra anë gëzojmë të drejtat tona të patjetërsueshme të njeriut, duhet gjithashtu të respektojmë në çdo kohë edhe të drejtat e të tjerëve. Ne, si individë, mund të ndihmojmë në mënyrë aktive për të sjellë ndryshimin.

Sot, duke shënuar Ditën e të Drejtave të Njeriut, më lejoni edhe një herë t'ju ftoj:
Ta gëzoni jetën dhe të ndihmoni edhe të tjerët të gëzojnë jetët e tyre!

Faleminderit shumë!

Fund